

# RELACION

## PËR

### AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.115/2021, “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”, TË NDRYSHUAR”

#### **A. MËNYRA E NDËRHJRJES**

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative, me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë<sup>1</sup>:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

#### **1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:**

Neni 101 ka parashikuar ‘nevojën’ dhe ‘urgjencën’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas vlerësimit vjetor të treguesve fiskalë, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të fundit të buxhetit 2022, i cili ka për qëllim shpërndarjen e paketës së re të fundvitit për qytetarët, në formën e pagesave të menjëhershme për një sërë kategorish të shtresave sociale.

#### **2. Përkohshmëria**

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli

---

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

## **B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTAKTIT**

Ky rishikim i buxhetit 2022, i cili propozohet t'i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, ka si synim kryesor:

- reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritjeje, në masën rreth 1.5 mld lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore.
- alokimin e një shtese fondi prej rreth 7.8 miliardësh lekë në zërin 'Fondi rezervë', me qëllim akordimin e një mbështetjeje financiare të menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës për disa kategori, në kuadër të mbylljes së vitit 2022.
- ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

## **C. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTLIGJI**

Mbështetur në vlerësimin e ecurisë vjetore të treguesve makrofiskalë dhe buxhetorë, paraqiten në vijim propozimet konkrete në kuadër të rishikimit të fundit të ligjit të buxhetit 2022, i cili reflekton këto elemente kryesore:

Në aspektin makro:

Në këndvështrimin e parametrave makroekonomikë, ky akt normativ parashikon:

- ruajtjen e pandryshuar të borxhit publik;
- ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor, në nivelin 83 863 milionë lekë.

Në kahun e të ardhurave:

Ky akt normativ parashikon rritjen e planit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore me 1.48 miliardë lekë, bazuar në performancën e vjeljes së tyre mbi planin 2022.

Në kahun e shpenzimeve:

Propozimet sa i takon zërave të shpenzimeve buxhetore konsistojnë në rritjen në terma NETO me +1.48 miliardë lekë të shpenzimeve të përgjithshme, të cilat arrijne nivelin 667.2 miliardë lekë. Kjo vlerë vjen si rezultat i axhustimeve/kursimeve mes zërave, të cilat shkojnë në drejtim të akomodimit të një fondi prej rreth 7.8 miliardë lekësh, me qëllim mbështetjen financiare të

menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës, për disa kategori dhe konkretisht:

- në masën 8 000 lekë për çdo pensionist;
- në masën 8 000 lekë, për çdo përfitues të skemave të ndihmës ekonomike dhe sftësisë së kufizuar;
- në masë të diferencuar për të gjithë punonjësit buxhetorë, përfshirë mjekë/infermierë/arsimtarë/policë/zjarrfikës etj.

Në përfundim, vlen të theksojmë se ndryshimet e propozuara nuk prekin deficitin buxhetor i cili nuk ka pësuar ndryshime.

### **KËSHILLI I MINISTRAVE**